



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

REPUBLIC OF KOSOVO KOSOVË ZRYRË E KONTABILITIMIT MINISTRI E TREGTISË DHE BASHKËPUNËSIAVE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Titulli / Title		Data / Date	
		4 07 2022	
Titulli / Orig. Jsh. / D. E. C. / Title	Sht. Kod / Klasif. Kod / Class. Code	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Faqet / Pajet / B. Stranica / No. Pages
05	47	1143	5

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit

Menaxhmenti i Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) ka hartuar një plan të veprimit për zbatimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), pas auditimit të Përformancës së RTK-së për periudhën 2019, 2020 dhe 2021.

Me qëllim që RTK-ja të krijojë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive permbushjen e misionit të vet, menaxhimin e stafit, realizimin e programeve dhe menaxhimin e fondeve publike, Shërbimi i Administratës dhe Burimeve Njerëzore, menjëherë, ka filluar t'i procedoj dhe të zbatojë në praktikë të gjeturat fillestare që prej kohës kur ishte duke u zhvilluar procesi i auditimit.

Nga ZKA-ja është kërkuar që një plan i tillë t'i prezantohet deri në fund të muajit qershor 2022, dhe një raport i veçantë mbi zbatimin e këtij plani t'i dorëzohet ZKA jo më vonë se më 31 dhjetor 2022.

Nisur nga këto, Menaxhmenti i RTK-së ka përgatit një plan të veprimit për Bordin e RTK-së, i cili do duhej të miratohet dhe të filloj zbatimin urgjent të tij, ashtu sikurse është kërkuar nga Raporti i ZKA-së për çështjet dhe rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1

Janë shqyrtuar nevojat për rekrutimin e stafit të ri dhe angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe se janë marrë masat e nevojshme me rastin e angazhimeve të bashkëpunëtorëve të jashtëm në pozitat përkatëse.

Plani veprimit

Është zbatuar rekomandimi i Bordit për ndërprerjen e kontratave me shërbime për bashkëpunëtorët e jashtëm. Nga data 31.03.2022 janë shkëputur kontratat për shërbime, gjegjësisht për bashkëpunëtorët e jashtëm profesionalë në përjashtim të dy kontratave me shërbime të cilat janë vazhduar për prezantuesit të cilësohen si ikona të Televizionit, bazuar në rregullativën e brendshme. Gjithmonë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, të njëjtit realizojnë pagesat vetëm pas arritjes së konfirmimeve për angazhimet e tyre duke specifikuar ditët e angazhimit me arsyetimet adekuate. (Ligji nr 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve)

Pozitat tjera të lira janë plotësuar nga stafi i brendshëm pas procesit të sistemimit. Pastaj janë shpallur konkurset për rekrutimin e stafit në sektorët ku ka pasur nevojë të domosdoshme.

Rekomandimi 2

Respektohen procedurat e rekrutimit sipas udhëzimit administrativ në fuqi nga komisionet për përzgjedhje të kandidatëve dhe, për të qenë sa më transparent, të specifikohen afatet e përgjithshme si kohëzgjatja e kontratës dhe e periudhës provuese.

Plani Veprimit

Procedurat e rekrutimit janë realizuar sipas udhëzimit administrativ nr. 007/2017 për rekrutim në sektorin publik duke respektuar afatet ligjore për formimin komisioneve të përzgjedhjes dhe të ankesave. Janë respektuar të gjitha procedurat administrative të konkursit për zgjedhjen e kandidatëve dhe pjesëmarrjen e të përzgjedhurve (kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkurse për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme).

Në konkursat që janë shpallur pas të gjeturave nga ZKA-ja, tashmë ceket lloji i kontratës për të cilën është shpallur konkursi, kohëzgjatja e emërimit si dhe kohëzgjatja e periudhës provuese, konform udhëzimit administrativ Nr. 007/2017.

Rekomandimi 3

Të shpallet konkurs publik për të gjitha pozitat e rregullta që përzgjedhja e tyre të jetë transparente dhe konkurruese.

Plani Veprimit

Konkursat e shpallura janë bërë publike, përmes ueb-faqes rtklive.com me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe nivelit të transparencës. I gjithë dokumentacioni gjendet në dosjen e secilit konkurs.

Gjithashtu është përmirësuar asistenca e Shërbimit të Administratës në mbështetjen e komisioneve të përzgjedhjes dhe komisionit të ankesave duke iu ofruar komisioneve sqarime, plotësime dhe kërkuar respektimin e afateve kohore ligjore. Shërbimi i Administratës dhe burimeve njerëzore do të punojë ngushtë dhe insistojë në komisionet përzgjedhëse për zbatimin e të gjeturave nga ZKA-ja dhe dhënien e arsytimit të detajuar për piket dhe vlerësimet e kandidatëve në proceset e rekrutimeve.

Rekomandimi 4

Të fuqizojë kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrjen për menaxhimin e fuqisë punëtore, të eliminojë të gjitha parregullsitë rreth avancimit, sistemimit, vlerësimit të rezultatit në punë dhe pagesave të shujtës.

Plani Veprimit

Avancimi i stafit të rregullt në RTK është menaxhuar në mënyrë tjetër:

* janë plotësuar modifikuar dhe përpiluar formularët e rinj për avancim dhe risistemim.

* është kërkuar më shumë arsyeshmëri më të detajuar në propozimet paraprake,

* është inkorporuar rubrikë e veçantë për mendimin dhe të gjeturat në Shërbimin e Administratës (duke përfshirë dosjen e të punësuarit dhe duke analizuar të gjitha detajet për periudhat paraprake)

* ka filluar të respektohet hierarkia në marrjen e nënshkrimeve

* janë ndërprerë praktikatat e mëhershme të avancimeve të personave të pakualifikuar

* janë ndërprerë praktikatat e avancimeve të pa bazuara në rregulloret e RTK-së.

Sistemimi i stafit të rregullt është analizuar me kujdes dhe janë marr vendimet e duhura vetëm duke u bazuar në rregulloret në fuqi. Formularët e rinj të sistemimit janë treguar mjaft efikas dhe kanë arritur të zvogëlojnë parregullsitë paraprake.

Sa i përket vlerësimeve të rezultateve në punë (VRP), Shërbimi i Administratës ka kërkuar dhe insistuar nga të gjitha njësitë në nivel të RTK-së që të përmbushin obligimet kontraktuale që të realizojnë këtë proces dhe të dorëzojnë në Administratë formularët e plotësuar. Pas arritjes, të njëjtit formularë janë protokollar dhe arkivuar;

Evidentimi i stafit në punë dhe pagesa e shujtës është zbatuar me prioritet. Pas shfuqizimit të vendimit nr 2501/16 përmes së cilit liroheshin nga evidentimi i pranisë në punë një pjesë e stafit, nga të gjeturat janë ndërprerë 9 (nëntë) kontrata të punës me vendim të Komisionit Disiplinor. Në mungesë të ID kartelave është përgatitur lista e veçantë për evidentim në portë (hyrje-dalje). Pas sigurimit të ID kartelave është njoftuar i gjithë stafi i RTK-së për tu furnizuar me to dhe evidentuar praninë në punë.

Rrjedhimisht është ngritur vetëdijësimi dhe është rritur prania e stafit. Kjo ka rezultuar me rritje të numrit të kërkesave për arsyetim të pushimeve vjetore, mjekësore apo pushime pa pagesë.

Së fundi, përmes një kompanie të specializuar, jemi në proces të zbatimit të lidhjes automatike të sistemit të evidentimeve të hyrje-daljeve me kalkulimin e shujtës për ditë. Sipas kompanisë së autorizuar, ky shërbim do të fillojë së zbatuari deri në fund të muajit korrik ose gusht 2022.

Rekomandimi 5

Rregulloret dhe organogrami të rishikohen në baza të rregullta kohore dhe azhurnohen e plotësohen konform nevojave reale dhe aktuale të RTK-së.

Plani Veprimit

Menaxhmenti dhe Bordi i RTK-se do të hartojnë dhe plotësojnë rregullore të brendshme. Sivjet është miratuar rregullorja për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të lartë të RTK-së. Rregullorja e dytë për parandalimin e konfliktit të interesit është në proces të diskutimit në Bord dhe pritet të miratohet së shpejti.

Rekomandimi 6

Të ndërpriten praktikatat e mos-respektimit të orarit të punës që ndërlidhen me sistemin e vijueshmërisë.

Plani Veprimit

Më 04.03.2022 është shfuqizuar vendimi me numër protokollit 2501/16 i datës 15.08.2016 në bazë të të cilit liroheshin nga evidentimi ditor i pranisë në punë disa kategori të caktuara të punëtorëve. Po të njëjtën datë, më 04.03.2022 është marr vendim i ri me numër të protokollit 0862/22, që i obligon të gjithë të punësuarit të evidentohen në baza ditore për praninë në punë.

Rekomandimi 7

Të ndërmarrin masat e duhura në mënyrë që vendimet që aprovohen me shumicën e anëtarëve të Bordit të respektohen nga ana e menaxhmentit.

Plani Veprimit

Të gjitha vendimet e bordit të RTK-së janë respektuar në tërësi.

Rekomandimi 8

Të merren parasysh nevojat e drejtorëve programorë dhe kriteret për përzgjedhjen programeve vendore nga producentët e jashtëm.

Plani Veprimit

Menaxhmenti është përcaktuar për zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim do të zbatohet qysh në konkursin e ardhshëm për veprat e jashtme audio-vizuele.

Rekomandimi 9

Të sigurojë një planifikim të detajuar të aktiviteteve të prokurimit i cili do të shmang në të ardhmen nevojat për angazhimin e anëtarit të njëjtë si në komision për përzgjedhjen e veprave audiovizuele po ashtu edhe në komision për vlerësim të tenderit.

Plani Veprimit

Ky rekomandim do të zbatohet në përpikmëri gjatë këtij viti.